

Ekskluzive

Ekskluzive | Dasma në Milloshevë përfundon me pranga – dy të rinj shtinë me armë, Policia sekuestron arsenal municioni



Sinjali.com

02 Gusht 2026 12:05



Një aheng familjar në fshatin Milloshevë u ndërpre nga Policia, pasi raportimet për të shtëna me armë zjarri çuan në arrestimin e dy personave dhe sekuestrimin e armëve e municionit.

Sinjali mëson se të dyshuarit janë **Arif Jashari rreth 23-vjeçar** dhe **Anis Menxhiqi rreth 20-vjeçar**.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 1 gushtit, rreth orës 22:30, në rrugën “Dorentina Kastrioti” në Milloshevë, ku Policia mori njoftim për të shtëna me armë gjatë një dasme.

Njësitë relevante policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kanë kontaktuar organizatorin e ahengut, i cili ka deklaruar se djali i tij dhe një familjar tjetër kishin shtënë me armë zjarri gjatë festës.

Gjatë veprimeve hetimore, Policia ka sekuestruar dy pistoleta me gaz të tipit “Zoraki”, 104 fishekë të kalibrit 9 mm, dy gëzhoja, si dhe një pajisje optike (laser), të cilat janë marrë në cilësinë e provave materiale.

Dy të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin Policor në Obiliq, ku janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj tyre është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, ndërsa të dy janë ndaluar për 48 orë.

Rasti është duke u hetuar.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera